
STATUT

“AESKULAP”

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

KAPITULLI I

Emri, Forma, Selia, Kohezgjatja

Neni 1. Emri

- 1.1 Emri i Shoqërisë është “AESKULAP” (“Shoqëria”), ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “shpk”, i cili përfaqeson formën ligjore të saj. Shoqëria do të prezantohet dhe do të zhvillojë aktivitetin e saj duke përdorur emrin “AESKULAP”. Shoqëria “AESKULAP shpk” është themeluar nga Ortaku i Vetëm Z. Edvin ZHUPA, lindur me 30/01/1975, në Sarandë dhe banues në Tiranë me Adresë: Rr. Hysen Zoloshnja, Nd. 2, H. 4, Ap. 40, Njesia Administrative nr. 5, 1022, Tiranë, identifikuar nga Karta e Identitetit nr. 032657185 dhe nr. personal H501300731.
- 1.2 Ortakët e Shoqërisë (“Ortakët”) gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkatës në kapitalin e shoqërisë të përfaqësuar në kuota.

Neni 2. Forma Ligjore

- 2.1. Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”(Ligji i Shoqërive).

Neni 3. Selia

- 3.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Dritan Hoxha” Njësia Bashkiake nr. 11 Ndertesa 92, seksioni 4, H28 Kati 0, Kodi Postar 1026, Tiranë – Shqipëri.
- 3.2. Selia e Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Administratorit(eve).

Neni 4. Kohezgjatja

- 4.1. Kohezgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

KAPITULLI II

Objekti

Neni 5. Objekti i Shoqerise

5.1. Objekti i veprimtarive te Shoqerise eshte :

Import export pajisje mjekesore,tregti kite reagente aparatura mjekesore laboratorike,kurim semundjesh,sherbim obstetrik ,dhenie ne perdorim aparatura etj dhe cdo aktivitet ekonomik qe do te konsiderohet i nevojshem dhe i dobishem ne menyre qe te permbushet qellimi i veprimtarise dhe qe nuk bie ne kundershtrim me legjislacionin shqiptar.

5.2. Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qe ben pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshtet ate.

5.3. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standardet me te larta te etikes.

Neni 6. Ndryshime

6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

KAPITULLI III

Kapitali Themeltar; Pjeset e Kapitalit Themeltar

Neni 7. Kapitali Themeltar

7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total 100 000 (njqind mije) Leke, i ndare ne 1 (nje) kuota, me nje vlere nominale prej 100000 (njqindmije) Leke secila, plotesisht te nenshkuara dhe te shlyera nga Ortaket.

Neni 8. Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat e zoteruara prej Ortakeve

8.1. Ortaket e Shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si meposhte :

- (i) Ortaku i vetem Z. Edvin Zhupa, lindur me 30/01/1975, ne Sarande dhe banues ne Tirane me Adrese: Rr. Hysen Zalosnjaja, Nd. 2, H. 4, Ap. 40, Njesia Administrative nr. 5, 1022, Tirane, identifikuar nga Karta e Identitetit nr. 032657185 dhe nr. personal H501300731.
- (ii) Kapitali i Shoqerise i regjistruar ne pronesi te Z. Edvin Zhupa eshte 100,000 (njqindmije) Leke, qe i korrespondon 1 (nje) kuote, qe perfaqesojne 100% (njqind) te kapitalit te Shoqerise .

Neni 9.**Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar**

- 9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te shoqerive.
- 9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.
- 9.3. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotesisht.
- 9.4. Zmadhimi i kapitalit nuk do te dobesoje pjeset e interesit te Ortakeve ne Kapitalin e shoqerise, pervecse kur Ortaket do te bien dakord ndryshe me vendim unanim te Ortakeve.

Neni 10.**Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve**

- 10.1. Ortake jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.
- 10.2. Cdo kuote i jep te drejten e nje vote cdo Ortaku, ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjithshme), te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, per cdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.
- 10.3. Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.
- 10.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.
- 10.5. Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne; Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne).
- 10.6. Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

Neni 11.**Transferimi i pjeseve te Kapitalit**

- 11.1. Transferimi i Kapitalit. Pjeset e Kapitalit mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me vendim ortaku. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme eshe ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

- 11.12 Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

KAPITULLI IV

Asambleja e Pergjithshme

Neni 12. Kompetencat

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtuesi Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 12.2 Vendimi i Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.Vendimi i Ortakut te vetem miraton cdo ndryshim te Statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj.Vendimi i Ortakut te Vetem brenda nje afati prej 6-muajsh ,duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar ,miraton Raportin e Administrimit,inventarin,bilancin dhe Llogarite Vjetore te hartuara nga Administratori.

Neni 13. Ndryshimet ne Statut

Vendimi i Ortakut te vetem miraton cdo ndryshim te Statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj. Cdo ndryshim Statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

KAPITULLI V

Administrimi dhe Perfaqesimi

Neni 14. Administratori dhe kompetencat

- 16.1 Shoqeria drejtohet dhe perfaqesohet nga Administratori. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithë personave fizike e juridike,publike dhe/ose private vendas apo te huaj,autoriteteve shteterore shqiptare apo te huaja,perfshi ketu autoritet gjygesore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep shprehimisht ortakut.
- Administratori angazhon shoqerine ne marredhenie me te tretet ne perputhje me aktet qe jane ne perputhje me objektin e e saj.
- Administratori ka te drejte te celi llogari bankare dhe te kryeje veprime prane bankave te te gjitha niveleve kudo ku shoqeria disponon llogari bankare.
- Administratori ka te gjitha kompetencat per te punesuar personelin e shoqerise duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i Administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt ne rrethanat e dhena ,duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne komtentat e administratorit ,te cilat rrjedhin nga ky nen duhet te respektohen nga te tretet.

Administratori apo ortaku qe nuk eshte person juridik nuk u lejohet te kontraktrojne ne cfaredolloj forme qofte ,te marrin hua te shoqeria,te japin pelqimin ne emer te saj per parardhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve,ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Neni 15 Kompetencat dhe detyrimet

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht .ndaj shoqerise ose ndaj te treteve ,per shkelje te ligjeve ,per shkelje te statutit ,apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise

Pasojat e marreveshjes te pamiratuara nga ortaku qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese .

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit,ortaku ka te drejte te ngreje padi penale kunder administratorit.

Paditesi ka te drejte te ndjeke ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise ,perfshire dhe demshperblimin financiar,nese eshte e nevojshme.Asnje vendim i ortakut nuk mund te ndaloje mngitjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KAPITULLI VI

Administrimi Financiar i Shoqerise

Neni 16. Eksperti Kontabel i Autorizuar

16.1 Nese kerkohet, Ortaket duhet te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.

16.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

KAPITULLI VII

Aktiviteti Shoqerise

Neni 17. Viti ekonomiko-financiar

Viti ekonomiko-financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne datën e themelimit te Shoqerise.

Neni 18. Mbajtja e Llogarive

Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 19. Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit

Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovuar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, marreveshjen e Ortakeve dhe me ligjet e zbatueshme.

Nga fitimet vjetore, do te caktohet nje fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.

Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimete kesaj te fundit;
- (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;

Administratori (et) leshon nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat mesiper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kriteret, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.

Administratori (et) pergjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

KAPITULLI VIII

Modifikimi i Formes Ligjore; Prishja

Neni 20. Modifikimi i Formes Ligjore

Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 12 ketu dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

Shoqeria e re do te permbushet te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 21. Prishja e Shoqerise

21.1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishtethemeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) hapje e nje procedure falimentimi;

-
- (iv) me vendim gjykate;
 - (v) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe.

Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njofton vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

Neni 22. Bashkimi dhe Ndarja

Shoqeria me anete bashkimit ,mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Shoqeria gjithashtu me ane te ndarjes mund ti kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ekzistuese apo shoqeri te reja.

Ortaku i shoqerise qe ben kalimin e trashegimise se saj ne kuadrin e operacioneve te permendura me lart perfiton pjese te kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompesim me para,vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10% te vleres Nominale te pjeseve te kapitalit themeltar.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen prishjen pa likuidim te shoqerise qe zhduket dhe kalimin e plote te trashegimise se saj te shoqerise perfituese ne gjendjen ne te cilen ndodhet kjo trashegimi ne daten e realizimit perfundimtar te operacionit.Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortakun e shoqerise qe zhduket ,marrjen e cilesise se ortakut te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

Neni 23.

Afati i emerimit te likuidatorit ,publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar prane QKB.

Neni 24.

Likuidatori eshte i detyruar te jete i vemendshem dhe korrekt ,si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve e debive qe shoqeria ka ndaj shtetit ,shtetasve te vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

Neni 25.

Cdo mosmarreveshje apo konflikt qe mund te lind gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise ndermjhet Ortakut dhe te treteve si rregull dhe pergjithesisht ortaku duhet ta zgjidhe me mirekuptim ne te kunderten ceshtja mund te behet objekt konflikti gjyqesor ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor te Tiranës.

Neni 26.

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Persa parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ",kodi civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne **Republikën e Shqipërisë**

Neni 28.

Shoqeria do te kete vulen dhe Logon e saj.

Ky statut hartohet me vullnetin e lire te Ortakut te vetem dhe nenshkruhet sipas ligjit.

ORTAKU I VETEM
Edvin ZHUPA



Tirane, 15 /11 /2018

Akti i Themelimit & Statuti i shoqerise
"Aeskulap"